



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112/02-13507
Datë: 27.08.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 65 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 11 të Rregullores (QRK) numër 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Planin e Personelit 2024 me numër PP00001707, pas kërkesës/pëlqimit me numër 01-112/02-13143 të datës 20.08.2024 nga nëpunësi **Shpend Kumnova** dhe **udhëheqësi i drejtpërdrejt i nëpunësit**, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësi **Shpend Kumnova**, i sistemuar në punë **Inspektor i Shërbimeve Publike** në kuadër të Drejtorisë për Inspektime, **transferohet** në pozitën e **Zyrtarit për Sport** në Sektorin për Sport – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. Vendi i ri i punës është i të njëjtës kategori sikurse vendi i mëparshëm, **sipas koeficientit 5** (klasa GJ35 sipas Ligjit numër 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).
3. Nëpunësi fillon punën në pozitën e Zyrtarit për Sport në Sektorin për Sport nga data **02.09.2024**.
4. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore brenda afateve ligjore duhet të bëjë përditësimet e nevojshme në akt emërimit e nëpunësit të shërbimit civil.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 20.08.2024 ka pranuar kërkesën numër 01-112/02-13143 nga nëpunësi Shpend Kumnova përmes të cilës kërkonte që ti mundësohet transferimi i përhershëm në pozitën e Zyrtarit për Sport në Sektorin për Sport – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Kërkesa e nëpunësit përmbante edhe pëlqimin e udhëheqësit të drejtpërdrejt të nëpunësit.

Nëpunësi civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil. Përgatitja profesionale e nëpunësit që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet. Transferimi i nëpunësit civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunësit civil. Arsytimi i vendimit të transferimit të përhershëm në interes të institucionit, përmban vlerësimin se nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet. Ky vlerësim kryhet nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e institucionit ku nëpunësi është i punësuar.

Pas shqyrtimit të kërkesës së nëpunësit, Kryetari i Komunës ka marr në konsideratë nevojat e kapaciteteve të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe në përputhje me Planin e Personelit 2024 me numër PP00001707 dhe pas vlerësimit nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes të cilës konfirmohet se nëpunësi i plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet, vendosi që nëpunësin Shpend Kumnova ta transferoj duke e ngarkuar me detyrat e Zyrtarit për Sport në Sektorin për Sport – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Bazuar në atë që u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i adresohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Nëpunësit Shpend Kumnova
- Drejtorisë për Inspektive
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini



Kryetar i Komunës së Gjakovës

